

MINISTRIA E FINANCAVE DHE
EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E DOGANAVE E REPUBLIKËS
SË
SHQIPËRISË

Nr. 5199 prot. Tiranë, më 28/02 2018

DOGANAT DHE TATIMET
E MADHËRISË SË SAJ
TË MBRETËRISË SË BASHKUAR
TË PËRBËRË NGA BRITANIA E
MADHE DHE IRLANDA E
VERIUT

Nr. _____ prot. Londër, më 28/02 2018

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI PËR BASHKËPUNIM DHE
ASISTENCË TË PËRBASHKËT PËR ÇËSHTJET DOGANORE

Palët, Doganat dhe Tatimet e Madhërisë së Saj të Mbretërisë së Bashkuar (HMRC) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë e Republikës së Shqipërisë;

Duke ndarë shqetësimin mbi rritjen e krimit tatimor dhe doganor që lidhet me fushë-veprimin e këtyre institucioneve, e luftën kundër krimit si kompetencë e tyre;

Të bindur se shkeljet e ligjit doganor janë në dëm të interesit ekonomik, fiskal dhe social të vendeve respektive;

Me dëshirë për të zhvilluar dhe forcuar bashkëveprimin në praktikë lidhur me çështje të interesit të përbashkët, veçanërisht në luftën kundër krimeve të lart-përmendura;

Të bindur se përpjekjet për të parandaluar veprimtarinë kriminale mund të jenë më të efektshme në rast se ka bashkëpunim më të afërt mes këtyre institucioneve, kanë arritur një marrëveshje mirëkuptimi të përbashkët;

Duke patur parasysh Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, të vitit 1948;

Palët kanë vendosur si vijon:

NENI 1

Qëllimi i Bashkëpunimit

1. Ky Memorandum Mirëkuptimi lidhet me bashkëveprimin në çështjet penale dhe ligj-zbatuese brenda kompetencave të Palëve. Ky Memorandum nuk merret me çështjet administrative doganore.
2. Ky Memorandum nuk mbivendoset ndaj detyrimeve që Mbretëria e Bashkuar ka sipas legjislacionit të Bashkimit Evropian lidhur me detyrimet aktuale dhe të ardhme si një Shtet Anëtar i Bashkimit Evropian apo si fqinj i afërt me Bashkimin Evropian dhe çdo legjislacioni që vepron në zbatimin e këtyre detyrimeve, e gjithashtu detyrimet aktuale dhe detyrimet e së ardhmes që dalin nga marrëveshje ndërkombëtare.
3. Ky Memorandum respekton Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, të vitit 1948 dhe Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, të vitit 1950 dhe legjislacionit në fuqi të secilës Palë. Ky Memorandum nuk bazohet në ligjin ndërkombëtar dhe nuk duhet të perceptohet si dokument detyrues ligjor për t'u zbatuar.
4. Të gjitha veprimtaritë që ndërmarrin Palët, bazuar në këtë Memorandum, duhen kryer bazuar në legjislacionin dhe rregulloret përkatëse të Palëve dhe bazuar në çdo marrëveshje ndërkombëtare të përshtatshme për t'u zbatuar ku qeveritë e Palëve janë pjesëmarrës me të drejta të plota në to. Ky Memorandum nuk ka qëllim që të:
 - a) krijojë apo të këshillojë ndonjë të drejtë, privilegj apo përfitim mbi asnjë person, palë, palë e tretë, apo entitet, qoftë publik apo privat, apo të
 - b) krijojë pritshmëri legjitime për ndonjë person se secila nga Palët do të kryejë ndonjë veprimtari (në asnjë moment, apo në ndonjë mënyrë tjetër apo në çdo kohë tjetër), ose do të shmanget nga kryerja e çdo veprimi tjetër.

NENI 2

Objektivat e Bashkëpunimit

1. Aty ku lejohet nga ligji i Palëve, Palët vendosin të bashkëpunojnë për të:
 - a) siguruar përdorimin e efektshëm dhe eficient të burimeve të Palëve për të mbrojtur juridiksionin e tyre nga trafikimi i paligjshëm i mallrave;
 - b) vendosur dhe mbështetur marrëdhënie pune të përbashkëta mes Palëve lidhur me respektimin e mbrojtjes kufitare dhe lidhur me funksionet e sigurisë;

- c) zhvilluar dhe përforcuar bashkëveprimin në praktikë në çështje me interes të përbashkët dhe për të lehtësuar këtë marrëdhënie dhe bashkëpunim duke shkëmbyer përvojat në fusha që kanë interes të përbashkët;
- d) dhënë mbështetje në përmirësimin e modelit të ligj-zbatimit doganor të orientuar nga informacioni dhe analiza e riskut.

NENI 3

Bashkëveprimi

1. Aty ku lejohet nga ligji specifik i secilës palë, Palët do të kenë si qëllim të arrijnë një nivel të lartë bashkëpunimi, mbështetje dhe të ndihmojnë njëri-tjetrin sipas kërkesës apo edhe bazuar në iniciativën institucionale, në çështje që bien nën kompetencën përkatëse, gjithnjë duke u bazuar në legjislacionin, rregulloret dhe procedurat e zbatueshme në juridiksionin përkatës.
2. Veçanërisht, asistenca mund të përfshijë:
 - a) marrja e provave, raporteve dhe objekteve atherë kur nuk ka detyrime ligjore për të mos e zhvilluar këtë veprim;
 - b) sigurimin e dokumentave dhe materialeve të tjera;
 - c) gjetjen e vendndodhjeve dhe identitetin e personave apo objekteve;
 - d) shkëmbimin e informacionit, duke përfshirë informacionin e përpunuar, analizën e riskut dhe informacionin rreth trendeve dhe indikatorëve të analizës së riskut, me qëllim parandalimin, gjetjen, goditjen dhe hetimin e shkeljeve që përfshihen në këtë Memorandum Mirëkuptimi;
 - e) dhënien e komenteve mbi përfundimet e arritura nga informacioni i përpunuar, informacioni i thjeshtë dhe asistenca e dhënë, duke përfshirë rastet e sekuestrimeve të produkteve të cigares e duhanit;
 - f) shkëmbimi i njohurive dhe përvojës, dokumentave rregullatorë dhe ligjorë dhe informacionin teknik.
3. Palët kanë si qëllim që të kenë qasje të përbashkëta në fushat në vijim por edhe në fusha të tjera:
 - a) operacione të përbashkëta dhe të sinkronizuara;
 - b) ndarjen e burimeve dhe proceseve për të identifikuar dhe për t'iu kundërpërgjigjur pikave të dobta të identifikuar në çështjet e sigurisë dhe kërcënimeve kriminale, dhe për të përmirësuar zbatimin e ligjit;
 - c) identifikimin dhe kundërpërgjigjen në fusha të përbashkëta dhe të ndryshme të menaxhimit të riskut;
 - d) ndarjen e përvojës dhe informacionit të përpunuar për qëllime të vendosjes në shënjestër të subjekteve që shkelin ligjin;

- e) identifikimin e mundësive për koordinim më të mirë në lidhje me trajnimin dhe zhvillimin e personelit.

NENI 4

Kërkesat

1. Kërkesa për asistencë duhet dërguar me shkrim. Megjithatë, në raste urgjente, Pala dhënëse e informacionit mund të pranojë dhe një kërkesë me gojë. Çdo kërkesë me gojë, duhet konfirmuar dhe duke u dërguar me shkrim brenda 48 orëve, përveç rasteve kur Pala dhënëse e informacionit lejon afat tjetër.
2. Një kërkesë të ardhur i duhet dhënë përgjigje sa më e plotë dhe sa më e shpejtë bazuar në procedurën e vendosur nga ligjet dhe rregulloret që qeverisin këtë veprimtari të Palës dhënëse të informacionit.
3. Pala dhënëse e informacionit, duhet t'i japë komentet e saj Palës kërkuese të informacionit për çdo përfundim të arritur në çdo hetim.

NENI 5

Llojet e Veçanta të Asistencës

1. Sipas kërkesës, Pala kërkuese e informacionit, brenda limiteve të kompetencës së saj dhe burimeve të disponueshme, duhet të mbikqyrë dhe të japë informacion mbi:
 - a) mallrat që po transportojnë, kalojnë tranzit apo janë magazinuar, të cilat ka dyshime se janë përdorur apo po përdoren në kryerjen e një shkelje të mbuluar nga ky Memorandum Bashkëpunimi;
 - b) mënyrat e transportit që njihen ose dyshohen se janë përdorur në shkelje apo thyerje të ligjit doganor;
 - c) vendndodhje të cilat ka dyshime se janë përdorur apo po përdoren në shkelje apo thyerje të ligjit doganor;
 - d) njerëz mbi të cilët ka dyshime apo njihen se kanë thyer ligjin doganor në territorin brenda juridiksionit të Palës kërkuese të informacionit.

NENI 6

Refuzimi i Kërkesës

1. Pala që kërkohet të japë informacion, mund të refuzojë përmbushjen e kësaj kërkesë për asistencë nëse:
 - a) Ekzekutimi i kësaj kërkesë mund të thyente të drejtat e njeriut;
 - b) Nuk sigurohet një standard i mjaftueshëm për mbrojtjen e të dhënave personale;

- c) Ekzekutimi i kësaj kërkesë mund t'i shkaktojë dëme sovranitetit, sigurisë dhe/apo interesave të tjerë të rëndësishëm të juridiksionit të Palës apo bien ndesh me dispozitat ligjore të juridiksionit të Palës;
 - d) Nëse Pala dhënëse e informacionit, beson se ekzekutimi i kësaj kërkesë mund të shkaktojë ndërhyrje në një hetim në vazhdimësi, apo në një hetim të propozuar, dërgesën në prokurori apo gjykatë bazuar në juridiksionin përkatës. Megjithatë, në këtë rast, duhet marrë parasysh mundësia e shtyrjes në kohë të ekzekutimit të kësaj kërkesë, duke pasqyruar kështu dhënien e asistencës ndërsa mbahen nën mbikqyrje kushte të caktuara. Nëse Pala dhënëse e informacionit pranon asistencën konform këtyre kushteve, duhet që kjo Palë t'i zbatojë ato.
2. Nëse Pala prej të cilës kërkohet informacion refuzon të japë asistencë, Pala kërkuese e informacionit duhet të lajmërohet mbi këtë refuzim brenda 30 ditëve.

NENI 7

Konfidencialiteti dhe Përdorimi i Informacionit

1. Palët kanë për qëllim që, në përputhje me legjislacionin e brendshëm, të mbajnë konfidenciale kërkesat dhe përmbajtjen e këtyre kërkesave.
2. Informacioni që lidhet me persona të identifikueshëm duhet shkëmbyer sipas të drejtave të Konventës, dhe duhet ruajtur në mënyrë të sigurtë sipas standardeve mbizotëruese Kombëtare dhe Evropiane.
3. Informacioni i përftuar si rrjedhojë e këtij Memorandumi duhet përdorur vetëm për qëllimet për të cilin është kërkuar. Në rast se njëra Palë kërkon përdorimin e informacionit për qëllime të tjera, Pala tjetër duhet t'ia miratojë me shkrim këtë kërkesë më parë.
4. Palët pranojnë që ata nuk mundin të ndajnë informacionin me asnjë agjenci tjetër apo partner tjetër ndërkombëtar pa marrë më parë leje të shprehur nga Pala që jep informacion.
5. Asnjëra nga Palët nuk detyrohet të ndajë informacionin në rast se ka rrezik që ky informacion të përdoret në shkelje të të drejtave të njeriut dhe të legjislacionit të secilës palë për mbrojtjen e të dhënave.
6. Palët kanë rënë dakord që të njoftojnë me shkrim njëra-tjetrën sa më parë që është e mundur pasi të kenë marrë dijeni për çdo qasje, përdorim, shpërndarje, modifikim apo agjesim aksidental apo të paautorizuar të informacionit të ndarë sipas këtij Memorandumi Bashkëpunimi. Informacioni i marrë sipas kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi pritet që të zotërohet deri atëherë sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimet e shprehura në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi dhe bazuar në ligjin, rregulloret, politikat, procedurat dhe të tjera direktiva drejtuese, duke përfshirë edhe ato që janë të lidhura me mbrojtjen e të dhënave personale,

të Palës të cilës i kërkohet informacion, dhe pritet që ky informacion të asgjësohet totalisht pas përdorimit bazuar në legjislacionin, rregulloret, politikat, procedurat, dhe të tjera direktiva qeverisëse të Palës dhënëse të informacionit.

NENI 8

Këshillimi

Palët kanë për qëllim që të këshillohen me njëri-tjetrin në mënyrë që të marrin masat për vazhdimin e efektshëm të implementimit të këtij Memorandumi. Çdo vështirësi e hasur si rezultat i veprimit të mbështetur në këtë Memorandum duhet zgjidhur nëpërmjet këshillimit mes Palëve.

Ky Memorandum Bashkëpunimi nuk i ndalon Palët që të bashkëveprojnë dhe t'i japin asistencë njëra-tjetrës bazuar në dispozitat e çdo traktati dhe marrëveshje që zbatohet.

NENI 9

Amendimet

Të gjitha amendimet në këtë Memorandum që do të bëhen në të ardhmen duhen bërë me shkrim dhe me miratimin e të dy Palëve.

NENI 10

Kohëzgjatja e Memorandumit

1. Ky Memorandum është i vlefshëm për një periudhë pesë vjeçare. Në rast se asnjëra prej Palëve nuk e përfundon në mënyrë të njëanshme këtë Memorandum, ai rinovohet automatikisht për një periudhë tjetër pesë vjeçare.
2. Secila nga Palët mund të anulojë Memorandumin duke e njoftuar me shkrim Palën tjetër. Përfundimi i Memorandumit hyn në fuqi gjashtë muaj nga data e marrjes së njoftimit.

NENI 11

Mosmarrëveshjet

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga ky Memorandum, duhet të zgjidhet miqësisht mes Palëve dhe nëpërmjet kanaleve përkatëse diplomatike.

NENI 12

Shpenzimet Financiare

Në rast se nuk ka marrëveshje tjetër me shkrim, Palët zotohen të mbulojnë shpenzimet e tyre përkatëse në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga ky Memorandum, në varësi të disponueshmërisë së këtyre fondeve, ligjeve përkatëse dhe autoriteteve të tjera ligjore të përfshira në këtë rast.

NENI 13


Hyrja në Fuqi

Ky Memorandum hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

Nënshkruar në Londër, më datë 28 . 02 .2018, në katër origjinale, në gjuhën shqipe dhe angleze, në katër tekstet autentikë dhe me fuqi të barabartë.

PËR


DREJTORINË E PËRGJITHSHME
TË DOGANAVE TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË



BELINDA IKONOMI

PËR

DOGANAT DHE TATIMET E
MADHËRISË SË SAJ TË
MBRETËRISË SË BASHKUAR



PENNY CINIWICZ